


PËRDORIMI I IA-SË NË KRIJIMIN E PËRMBAJTJES



A ke parë ndonjë foto ose artikull që duket sikur ka diçka që nuk shkon? Ka shumë mundësi që të jenë krijuar nëpërmjet Inteligjencës Artificiale! Edhe pse IA-ja është përmirësuar shumë vitet e fundit, nuk është ende në gjendje të krijojë gjithçka në mënyrë perfekte. Si për ironi, një nga mënyrat që programet kompjuterike (dhe njerëzit) e dallojnë përmbajtjen e krijuar nga IA-ja, është se këto produkte janë ca si tepër të përsosura, por njerëzit nuk janë të përsosur dhe shpesh bëjnë gabime. Të paktën, tani për tani mund t'i dallojmë.



Çfarë është përmbajtja e krijuar nga IA-ja?



Përmbajtjet e krijuara mund të jenë tekste, imazhe, muzikë dhe produkte mediatike të prodhuara me ndihmën e Inteligjencës Artificiale. IA-ja po ndryshon mënyrën se si po krijojmë dhe konsumojmë informacionin!

Si krijohet materiali mediatik nga IA-ja?

Është proces i ndërlikuar, por do të mundohemi ta shpjegojmë me terma të thjeshta. IA-ja mund të krijojë përmbajtje në dy mënyra:



01



Përpunimi i Gjuhës Njerëzore (Natural Language Processing - NLP): IA-ja analizon dhe përpunon gjuhën njerëzore për të gjeneruar tekst koherent, të kuptueshëm dhe kontekstual.



Modelet gjeneruese (Generative Models): Algoritmet, si Chat GPT-3, krijojnë përmbajtje duke parashikuar dhe gjeneruar sekuenca teksti bazuar në të dhënat që i jepen paraprakisht.

Aplikimet e përmbajtjes së krijuar nga IA-ja

01

Ndihmës të automatizuar shkrimi:

IA-ja i ndihmon nxënësit dhe studentët që të përmirësojnë aftësitë e të shkruarit dhe mund të shërbejë si udhëzues, duke sugjeruar mënyra për të përmirësuar cilësinë e shkkrimit.

02

Përmbledhja e përmbajtjes:

IA-ja mund të përmbledhë shumë shpejt tekste voluminoze, duke ndihmuar në punë kërkimore dhe përpunimin e informacionit.

03

Chatbot-et dhe Asistentë Virtualë:

IA-ja përmirëson punën e asistencës virtuale, duke i bërë ndërveprimet më efektive, të personalizuar dhe që tingëllojnë më të ngjashme me njerëzit.

04

Krijimi i imazheve:

IA-ja mund të marrë të dhëna bruto nga një përdorues — tekst ose imazh bazë — dhe duke përdorur modelet që janë futur në program, që përfshijnë miliona imazhe, mund të krijojë një imazh ose video të re.

Sfidat dhe Problemet

01

Probleme etike:

Duhet të sigurohemi që përmbajtja e krijuar është në përputhje me standardet etike dhe duhet të shmangen paragjykimet në materialet e krijuara nga IA-ja. Mund të ketë edhe probleme të tilla, si plagjiatura dhe e drejta e autorit, veçanërisht me krijimin e imazheve.

02

Varësia e tepërt nga IA-ja:

Është e rëndësishme që nxënës dhe studentë ta përdorin IA-në si mjet ndihmës dhe jo që të zëvendësojë krejtësisht kreativitetin dhe mendimin e tyre kritik. Ku është lezeti po t'i bëjë të gjitha makina?

Këshilla për përdorim të përgjegjshëm

01

Verifiko informacionin:

Kontrollo mirë përmbajtjen e krijuar nga IA-ja për saktësi dhe besueshmëri. Në varësi të programit, IA-ja mund t'i shpikë vetë burimet dhe informacionin, kështu që është e rëndësishme që gjithmonë të konfirmohet informacioni me një burim tjetër.

02

Duhet të kuptojmë si funksionojnë algoritmet:

Ndërgjegjësimi në lidhje me algoritmet që bëjnë të mundur funksionimin e IA-së na lejon që të kontrollojmë aktivitetin tonë online, pavarësisht nëse bëhet fjalë për zgjedhjen e muzikës ose filmave, ose për vlerësimin kritik të informacionit që gjejmë në internet, duke u siguruar që përvojat tona dixhitale përputhen me atë që na pëlqen me të vërtetë dhe që përkon me vlerat tona.